



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIMIT
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "THOMA PAPAPANO" GJIROKASTËR

Nr. 244 Prot.

Gjirokastrë, më: 13.09.2022

Lënda : Kërkesë për shpallje vendi të lirë, në pozicionin ,mësues i praktikës profesionale, drejtimi Termohidraulike në shkollën mesme profesionale : " Thoma Papapano", Gjirokastrë

(mundësi për lëvizje paralele)

Drejtuar: Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse
Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun
Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr. 15 datë 16/02/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019 "Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funkcionit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional", si dhe " Aspektet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Përbërjes së Njesisë së Zhvillimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Zhvillimit të Vazhduar Profesional të Personelit". Urdhërit nr. 172, datë 24.12.2019 "Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Profesionale", si dhe Udhëzimin nr. 28, datë 14.10.2019, "Për Numrin e Nxënësve për Klasë dhe Normat e Punës Mësimore në Institucionet e Arsimit Profesional "si dhe Urdhërin e Brendshëm me nr. 194 prot., datë 22/08/2022

Ju njoftojmë për një vend të lirë në pozicionin e mësuesit të praktikës profesionale, drejtimi mësimor Termohidraulikë

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit të AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

2..Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit të praktikës profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional:

a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë ose të përafërt me kualifikimin profesional të ofruesit të AFP-së, për të cilin po aplikon;

b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- Letërmotivimin për pozicionin;

- Jetëshkrimin (Cv-ne sipas shtojcës 11 të udhëzimit 14 dt. 27.05.2021.

- Kartën e identitetit;

- Diplomën;

- Librezën e punës;

- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet , trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

- Çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

- Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;

-Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;

- Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij ,nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi

-të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara; Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës

26.05 .2022 .

Drejtori

Renata Puleri

